



Të nderuar pjesëmarrës,

Dua fillimisht t'ju falenderoj për ftesën, për pjesëmarrjen në këtë konferencë, e cila ka në fokus edukimin financiar, i cilësuar si një nga prioritetet kryesore të punës së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare.

Edukimi financiar mbështet jo vetëm mirëqënien individuale, por edhe shëndetin e përgjithshëm ekonomik të vendit. Eksperiencën ka treguar se një qytetar me edukim financiar të ulët është shumë herë më i rrezikuar për t'u përballur me risqe të ndryshme, të cilat nuk i ka kuptuar, duke rënë pastaj pre e abuzimeve që mund të shkaktojnë edhe dëm të madh financiar për të.

Planifikimi i zgjuar financiar, përmes buxhetimit, kursimeve, sigurimit për emergjencat dhe përgatitjes për daljen në pension, mund të ndihmojë në shijimin e jetës, ndërkohë që çdo individ përballlet me sfidat apo tronditjet e mundshme financiare. Vitin e kaluar, pas miratimit të strategjisë për "rritjen e besimit të konsumatorit/investitorit në tregjet nën mbikëqyrje", Autoriteti nisi një fushatë informuese, duke zhvilluar takime dhe orë të hapura leksionesh në disa universitete të vendit, për të vazhduar edhe këtë vit, duke zgjeruar më tej edhe grupet e interesit.

Gjithashtu në fund të muajit maj, Autoriteti organizoi Konferencën e parë kombëtare për edukimin financiar, me fokus kryesor studentët, të cilët shpalosën punime të ndryshme në lidhje me tregjet nën mbikëqyrje dhe rëndësinë e edukimit financiar për zhvillimin e tyre. Autoriteti e cilëson konferencën fillimin e një dialogu të përbashkët me stafet akademike, ekspertë të tregjeve financiare jobankare dhe organizma që veprojnë në treg për të përcjellë ide të reja në përballimin e sfidave me të cilat ndeshen tregjet nën mbikëqyrjen e AMF-së.

Ne jemi të ndërgjegjshëm se tregjet financiare janë një fushë relativisht e re në shoqërinë shqiptare, madje edhe vetë institucioni, Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, rezulton të jetë pak i njohur. Nga një anketim me studentë, i ndërmarrë nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, vërehet se njohuritë e tyre për tregjet financiare jobankare, në mbi 90% të të intervistuarve, janë të pakta dhe të pamjaftueshme lidhur me letrat me vlerë, fondet private të pensioneve apo edhe fondet e investimeve. Për tregun e sigurimeve, niveli i informacionit është pak më i lartë, por i lidhur kryesisht me produkte të sigurimeve të detyrueshme, apo produktet që i lidhin studentët me procedurat e regjistrimit në shkollë.

Së fundmi, AMF miratoi dhe prezantoi strategjinë 5-vjeçare për zhvillimin e tregjeve nën mbikëqyrje, e cila ka si synim kryesor që t'i shndërrojë tregjet më të brishta financiare në Ballkanin Perëndimor në tregun më të konsoliduar për të qenë lider të rajonit drejt proceseve integruese në Bashkimin Evropian.

Fjalët kyçe që bashkojnë të gjithë Strategjinë janë Konsumatori dhe Investitori. Mbrojtja, fuqizimi dhe edukimi financiar i tyre janë prioritetet tona. AMF synon që nëpërmjet ushtrimit të funksioneve të saj mbikëqyrëse dhe rregulluese të rivendosë besimin e konsumatorit/investitorit në tregjet financiare jobankare, me qëllim ruajtjen e integritetit të këtyre tregjeve si një faktor me ndikim pozitiv në zhvillimin ekonomik të vendit.

Një tjetër aspekt frenues për zhvillimin e tregjeve është niveli i ulët i njohurive financiare tek individët, që në Shqipëri në bazë të studimeve ndërkombëtare është më i ulët se pjesa më e madhe e vendeve të rajonit. Edhe përqindja e popullsisë në Shqipëri që përdor sistemin financiar rezulton të jetë më e ulët se rajoni. Kjo ndikon negativisht në ndërgjegjësimin e individëve për shembull për nevojën e një pensioni privat vullnetar, në qasjen e tyre ndaj produkteve që ofrohen nga fondet e investimit apo dhe më vonë në qasjen ndaj tregut të kapitalit.

AMF synon të angazhohet në ndërtimin e iniciativave konkrete, me impakt afatgjatë, në bashkëpunim dhe me Bankën e Shqipërisë dhe institucione të tjera, për edukimin financiar në Shqipëri. Kjo duhet të përfshijë jo vetëm iniciativa afatshkurtra, fushatat e ndërgjegjësimit, por edhe përshtatjen e kurrikulave në sistemin shkollor parauniversitar për rritjen e nivelit të edukimit financiar në shkolla.

Vitin e kaluar, Shqipëria u përzgjedh si një nga 4 vendet fituese në Botë për Projektin e Mikrosigurimeve “Akses në Iniciativën e Sigurimeve” (A2ii). Projekti synon të promovojë dhe të zhvillojë produktet inovative për popullatën me të ardhura të ulëta, veçanërisht në fushën e bujqësisë, të biznesi i vogël, me synim rritjen e shkallës së përfshirjes së grupeve vulnerabël në skemat e sigurimit vullnetar me prime të ulëta.

Ekipi pjesëmarrës në këtë projekt po punon në disa faza për ndërtimin e besimit, lidhjeve bashkëpunuese, krijimin e dialogut për sigurimet vullnetare dhe gjetjen e formave, produkteve të reja për përballimin e sfidës së rritjes së pjesëmarrjes së popullsisë së gjerë në skema sigurimesh vullnetare.

Mikrosigurimet janë të rëndësishme për botën në zhvillim. Kjo, pasi në bazë të vlerësimeve rreth 60% e popullsisë jeton me më pak se 8 dollarë në ditë. Disa nga kompanitë e angazhuara për mikrosigurimet në Botë po investojnë në edukimin financiar, kështu që një nga përfitimet e tjera të mikrosigurimit është edhe promovimi i përfshirjes financiare dhe kulturës së sigurimeve. Mikrosigurimet karakterizohen nga volumi i lartë, kostoja e ulët dhe lehtësia e administrimit. Kjo edhe për shkak të përdorimit të gjerë të teknologjisë së informacionit. Përfshirja sa më e gjerë e popullsisë në skemat e sigurimit mund të realizohet nëpërmjet subvencionimeve të ndryshme, duke u shoqëruar me fushata informimi dhe edukimi.

Për këtë arsye, edukimi financiar merr një rëndësi edhe më të madhe, pasi ai vlerësohet të jetë i rëndësishëm jo vetëm në aspektin individual, referuar financave personale, por edhe në planin më të gjerë, për zhvillimin ekonomik në tërësi. Kjo për shkak se kontribuon direkt në reduktimin e varfërisë, në përfshirjen më të gjerë të popullsisë, në rritjen e mirëqënies së përgjithshme.